



Pranimi / Dorezuar Pranimi / Preschub- K. / received / Delivered	27.04.2022	2	viti god year
Organ / Shista Organ / Shista Org. / shist.	2461/2022	Shtypja / Proeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK			1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.301/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca - anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1788/2020 të datës 23.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativ, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.240/2020 të datës 24.08.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.301/2022 e datës 28.03.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Prizrenit, sipas akt emërimit të datës 01.01.2012, në pozitën “Anketues”, në Sektorin e Tatimit në Pronë dhe të Ardhura Tjera. Me datën 17.03.2022 Kryetari i Komunës së Prizrenit ka nxjerrë vendimin sipas të cilit ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me rastin e pensionimit, sipas të cilit vendim ankuesi gëzon të drejtën e një page shtesë më rastin e pensionimit dhe i cili është kompensuar bazuar në dëshminë mbi listën e pagave të dërguar nga organi i punësimit.

Me datën 20.07.2020, ankuesi ka parashtruar ankesën më numër të protokollit 65890 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit lidhur me pagesën e tri pagave jubilarë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prizrenit, me datën 07.08.2020 ka nxjerrë vendimin me numër 02-117-65890/1 sipas të cilit e ka hedhur si të pa lejuar

ankesën e ankuesit me arsyetimin se nuk është kompetent për shqyrtimin e saj ngase i njëjti nuk e ka statusin e nëpunësit civil që nga momenti i pensionimit.

I pakënaqur me vendimin e datës 20.07.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit, ankuesi me datën 24.08.2020 parashtron ankesën me numër të protokollit 1605/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin lidhur me pagesën për shpërblimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 03.09.2020, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1686/2020 për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa me datën 21.10.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prizrenit së bashku me provat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes shkresës me numër protokollit 2004/2020 të datës 07.10.2020, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës numër A.nr.240/2020 të datës 24.08.2020, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë në gjykatën kompetente në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativë, me datë 23.03.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1788/2020, i pranuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 23.03.2022, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të datës 07.10.2020 dhe obliguar të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit me numër A.nr.240/2020 të datës 24.08.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokollit 1605/2020 të datës 24.08.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 02-117-65890/1 të datës 07.08.2020 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit; ID e ankuesit; Vendimin e datës 17.03.2020 mbi përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit; Përgjigjen në kërkesë me numër 02-120-6487/02 të datës 17.07.2020 nga Komuna e Prizrenit për ankuesin; Listën e pagave për muajt janar, shkurt dhe mars të viti 2020 për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.09.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.10.2020 nga Komuna e Pejës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.01.2012; Ankesën e ankuesit me numër 65890 të datës 20.07.2020 e parashtruar për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër 02-117-65890/1 të datës 07.08.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Njoftimin me numër të protokollit 2004/2020 të datës 07.10.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e **pa bazuar**, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se me rastin e pensionimit punëdhënësi është i detyruar që t'ia paguaj tri paga jubilarë dhe tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive i cili pretendim ankimor i ankuesit është i pabazuar, sepse për kompensimet e

nëpunësve civil janë të aplikueshme dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nëpunësve civil me rastin e pensionimit ju takon kompensimi në vlerën e një page të njëhershme të pagës së fundit, e jo tri (3) pagave siç ankuesi pretendon, e kjo është e përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil që nëpunësi civil ka të drejtë të kompensohet me rastin e pensionimit dhe të dispozitave të nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, që përcakton se: *"1. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një page në shumën prej një (1) page mujore të njëherëshme në vlerën e pagës së fundit"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit se me ligjin e punës dhe Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës sipas nenit 52 dhe 53 me rastin e pensionimit i takojnë tri paga mujore jubilarë si dhe tri paga përcjellëse dhe Kolegji ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prizrenit, me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 17.03.2020 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit për ankuesin si dhe njohjen e kompensimit të një page pas moshës së pensionimit, është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marrë në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prizrenit, ka nxjerr Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datën 17.03.2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me të cilin vendim ankuesit i njihet e drejta e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit pas moshës së pensionimit, sipas dispozitave ligjore të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime dhe Kolegji në bazë provave të lëndës konkretisht në bazë të listës së pagave ka konstatuar se ankuesit iu është bërë pagesa.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi që nga data 17.03.2020, kur edhe është data e pensionimit të ankuesit e deri me datë 20.07.2020 kur me ankesë lidhur me kompensimin e tri pagave përcjellëse dhe shpërblimin e pagave jubilarë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës ju ka drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit, nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor, respektivisht ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka parashtruar kërkesë apo ankese në kuadër të institucionit të punësimit, edhe pse organi i punësimit në Vendimin e datës 17.03.2020

e ka udhëzuar ankuesin që kundër këtij vendimi ka të drejtë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: „Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.301/2022, datë 28.03.2022



Malsore GASHI-BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit

Ardita Përçuku-Shyti
Ardita Përçuku-Shyti
Procesmbajtëse

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit ;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

